



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

C.nr.34/13

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtorin profesional Arlind Sharani, në çështjen juridike të paditësit M. B. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. Y. K. nga Prizreni, kundër të paditurit I. M. “F.-K.” – Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson av. V. R., nga Prizreni, për shkak të anulimi i vendimit dhe kthimit në vendin e punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 16.12.2014 morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M. B. nga Prizreni, **ANULOHET** si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës HR 2013/07 i datës 30.01.2013, me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, **DETYROHET** e paditura I. M. “F.-K.” me seli në Prishtinë, që paditësin M. B. nga Prizreni, ta kthej në punë, në pozitën në të cilën ka qenë duke punuar dhe t’ia kompensoj pagat për periudhën që paditësi nuk ka punuar në shumën e parave prej 14.162.75€, me kamatë ligjore të cilën e aplikojnë bankat private, për mjetet e deponuara në afat prej 1 (një) viti pa destinim të caktuar nga data e marrjes së aktgjykimit e deri në pagimin përfundimtar, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura I. M. “F.-K.” me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguajë shpenzimet procedural në shumën prej 955€, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi M. B. me datë 15.11.2013, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës I. M. “F.” me seli në Prishtinë, me objekt të padisë anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthim në vendin e punës së dt.21.03.2011, ku ka theksuar se paditësi me të paditurën ka lidhur marrëdhënie të punës në kohë të pacaktuar qysh në vitin 2004, së pari në postin e nëpunësit të kredive, e paditura me vendimin e komisionit disiplinor, paditësin me dt. 22.06.2010 e përjashton nga puna përfundimisht me dt. 25.07.2010 për shkak të performancës së dobët, me aktgjykimin e plotfuqishëm C.nr. 531/10 të dt. 28.10.2011, Gjykata Komunale në Prizren e ka anuluar vendimin e të paditurës për përjashtimin nga puna dhe e ka obliguar të paditurën që paditësin ta kthejë në punë me të gjitha të drejta. E paditura konform aktgjykimit të plotfuqishëm paditësin e ka kthyer në punë duke i lëshuar një kontratë pune me afat të caktuar dhe të njëjtën ditë e suspendon nga puna përkohësisht deri në vendimin tjetër të Komisionit Disiplinor i cili do të shqyrtoj përgjegjësinë e paditësit, për shkeljen e detyrave të punës në lidhje me një kredi në rastin “Braha” në vitin 2008. Duke shtuar se për këtë rast

paditësi një herë veç ishte larguar nga puna, por Gjykata me aktgjykimin e lartcekur e kishte kthyer në vendin e tij të punës. Përfundimisht e paditura me njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr. HR2013/07 të dt. 04.01.2013, paditësi është njoftuar se pushon puna më 31.01.2013, për shkak të përfundimit të kontratës së punës konform nenit 67 par.1 pika 1.3 të Ligjit të Punës.

I autorizuari i paditësit av. Y. K. në shqyrtimin kryesor deklaroi se mbetet në tërësi në të cekurat si në padi dhe kërkesëpadi si dhe në përgjigjen e dhënë në padi me datë 26.03.2014, duke kërkuar që padia dhe kërkesëpadi të aprovohet si e bazuar. Edhe në fjalën përfundimtare të cilën e ka dorëzuar në formë të shkruar i autorizuari i paditësit ka theksuar se i padituri për herë të dytë në mënyrë të padrejtë e ka përjashtuar nga puna për arsyet e njëjta si edhe herën e parë për rastin “Braha” i cili rast njëherë është shqyrtuar nga kjo gjykatë me aktgjykimin C.nr. 531/10 si dhe në çështjen penale nga ana e prokurorisë me numrin PP.nr.367/2012, ku është vërtetuar se paditësi nuk ka asnjë përgjegjësi për rastin në fjalë. Andaj duke i marrë për bazë këto fakte si dhe mashtrimin e bërë nga ana e paditur për nënshkrimin e kontratës së punës me dt. 10.11.2012, e cila sipas vlerësimit përbën një kontratë fiktive sipas LMD-së, duke kërkuar nga gjykata që pas administrimit dhe vlerësimit të provave të aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar dhe paditës të kthehet në vendin e tij të punës duke ja kompenzuar të gjitha të ardhurat prej datës 31.01.2013 deri më kthimin në punë, sipas ekspertizës të dhënë nga eksperti çështjes. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 1095 euro.

Në përgjigjen e dhënë në padi i padituri, ka theksuar e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke propozuar që Gjykata pas administrimit të provave të merr aktgjykim me të cilin kërkesëpadi e paditësit do të hudhet poshtë si e palejueshme ose të refuzohet si e pathemeltë. Pasi që me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate C.nr. 531/10 kjo çështje kontestimore është gjykuar, andaj gjykata duhet të hedh poshtë padinë. Gjithashtu konsideron se pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë pasi që nuk janë të argumentuar me asnjë provë të bazuar. Meqenëse paditësi në cilësinë e ish punëtorit ka shkelur rregullat e brendshme të punëdhënësit bazuar në të gjeturat e auditorit të brendshëm duke i shkakuar dëme financiare, punëdhënësi ka vendosur të ndjek penalisht këtu paditësin për shkak të përgjegjësisë së tij penale. Ndërsa në ndërkohë për shkak të skadimit të kontratës së punës, punëdhënësi – i padituri ka vendosur që paditësit për shkak të përgjegjësisë disiplinore të punëtorit në rastin “Braha” marrëdhënia e punës të mos vazhdohet. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: leximin e kontrata e punës ndërmjet paditësit dhe të paditurit e dt. 10.12.2012; aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Komunale në Prizren dt. 531/10 dt. 28.10.2011; vendimi i lëshuar nga i padituri me nr. të prot. Ref. No HR 2012/89 dt. 22.11.2012; ankesa e paditësit kundër vendimit të komisionit disiplinor Ref. No.HR 2012/87; vendimi Ref.No. HR 2012/91 dt. 24.12.2012 e lëshuar nga F. – K.; njoftimi për ndërprerjen e punës HR2013/07 dt.04.01.2013; aktvendimi i Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.367/2012 dt.14.11.2013; vendimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenies Sociale – Trupi ekzekutiv i inspektoratit të punës nr. 44/2013 dt. 20.02.2013; vendimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale – Trupi ekzekutiv i inspektoratit të punës nr.24/2013 dt.29.03.2013; kërkesa e paditësit për Inspektoratin e Punës të RK-ës zyrës në Prizren dt. 08.01.2013; raporti zyrtar i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale – Trupi Ekzekutiv i inspektoratit nr. 17/2013 dt. 24.01.2013; thirrja – i paditësit dërguar palës paditëse të datës 16.11.2012, 20.11.112012 dhe 29.11.2012; vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës e themeluar në kohë të caktuar nr. N.P. HR 2013/23 dt. 30.01.2013; vërtetimi i pranimit të dërgesës e dt. 30.01.2013 nga paditësi me dt. 01.02.2013; aneks ekspertiza e ekspertit financiar B. I. dt.10.11.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekur në kuptim të nenit 8 të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit **është e bazuar**.

Në bazë të vendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren C.nr. 531/10 dt. 28.10.2011, gjykata ka konstatuar se është anuluar vendimi i të paditurës dt. 22.06.2010 si i kundërligjshëm, dhe paditësi është kthyer në vendin e tij të punës me të gjitha të drejtat që i ka pasur para ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Se paditësi me kontratën e punës e dt. 10.12.2012, në kohë të caktuar ka qenë i punësuar te i padituri si nëpunës kreditor senior.

Me vendimin e Komisionit Disiplinor HR 2012/89 dt. 10.12.2012, punëtori M. B. këtu paditësi suspendohet nga marrëdhënia e punës, deri sa punëdhënësi këtu i padituri të verifikojë dyshimet lidhur me parregullsitë në degën F. K. në Prizren.

Me vendimin Kryeshefit Ekzekutiv Ref. No. HR 2012/91, rezultoi se është refuzuar ankesa e paditësit M. B. dhe është vërtetuar vendimi i Komisionit Disiplinor HR 2012/89 dt. 10.12.2012, lidhur me suspendimin nga marrëdhënia e punës të paditësit.

Me aktvendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të themeluar për kohë të caktuar N.P. HR 2013/23 dt. 30.01.2013, paditësit M. B., është shpallur përgjegjës për shkak se gjatë lëshimit të huave në rastin “Brah” *pasi që gjatë muajit Prill deri në Dhjetor 2008, ka paraqitur gjendjen e biznesit në mënyrë të rremë duke i vënë në lajthim anëtarët e komitetit kreditor të cilët kanë lejuar lëshimin e huave këtyre klientëve, e që po të kishin qenë në dijeni të gjendjes së saktë të klientit nuk do të kishin vepruar ashtu, e të cilat veprime kanë qenë të ndaluara me rregulloren e brendshme të punëdhënësit, për këto arsye edhe punëdhënësi i ndërprente marrëdhënien e punës.*

Me vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nr. 44/2013 dt. 20.02.2013, gjykata ka vërtetuar faktin *se ndaj të paditurit është shqiptuar gjopa në shumën prej 3000€, pasi që i padituri nuk i ka përfillur vërejtjet e inspektoratit lidhur me kthimin e të punësuarit – paditësit lidhur me të drejtat e garantuara nga marrëdhënia e punës e në përputhje me ligjin e punës.*

Me vendimin e Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale – Trupi ekzekutiv i inspektoratit të punës nr.24/2013 dt.29.03.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se është refuzuar ankesa e të paditurit F. I. në Kosovë dhe është vërtetuar vendimi i inspektorëve të punës nr. 44/2013 i dt. 20.02.2013.

Me aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Prizren, PP.nr. 367/2012 dt. 14.11.2013, gjykata ka vërtetuar faktin *se është hudhë kallëzimi penal i I. M. – F. – K. me seli në Prishtinë – Dega në Prizren, kundër M. B. sepse nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se ka kryer veprën penale për të cilën është dyshuar, apo për ndonjë vepër tjetër penale cila ndiqet sipas detyrës zyrtare apo propozimit.*

Nga ekspertiza financiare e datës 10.11.2014, për të ardhurat personale të paditësit, përfshirë periudhën prej ndërprerjes së punës me dt. 01.02.2013 e deri më 30.09.2014, eksperti i autorizuar gjyqësor B. I. ka përcaktuar se e paditura duhet t’i kompenzojë paditësin të ardhurat neto në paga në shumën prej 11,559.00€ e që së bashku me kamatat e llogaritura për 20 muaj në shumën prej 512.75€, ndërsa në emër të kontributeve pensionale shumën e paditura për paditësin duhet të transferoj në Trustin e Kursimeve pensionale shumën prej 1.300,00€ dhe në emër të tatimit në këto paga, administratës tatimore t’ia transferoj shumën e parave prej 791,00€.

Nga provat e administruar gjykata gjeti se ndërmjet palëve nuk ishte kontestuese fakti se në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komonale në Prizren C.nr. 531/10 dt. 28.10.2011, me të cilën vendimi i të paditurës dt. 22.06.2010, për përjashtimin e paditësit nga puna ishte anuluar si vendim i kundërligjshëm, dhe paditësi ishte kthyer në punë me të gjitha të drejta nga marrëdhënia e punës.

Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte fajësia e paditësit, për të cilën edhe ishte larguar nga puna duke mos ja vazhduar kontratën e punës, ngase sipas të paditurës në procedurën disiplinore ishte vërtetuar se paditësi gjatë aprovimit dhe lëshimit të huave në rastin “Braha” ka paraqitur gjendjen e biznesit të klientit në mënyrë të rreme, duke i vënë në lajthim anëtarët e komitetit kreditor, e cilët pastaj ka rezultuar me lëshimin e huave – kredive këtyre klientëve, të cilat veprime kanë qenë të ndaluara me rregulloret e brendshme të paditësit dhe arsye e mjaftueshme për mos vazhdim të kontratës.

Pas vlerësimit të provave të lartcekura, Gjykata vlerëson se e paditura me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës paditësit nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe si rezultat i kësaj vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i paligjshëm, kjo për faktin se nga provat e nxjerra, nuk është vërtetuar që paditësi të jetë përgjegjës për shkeljet në punë në rastin “Braha”, gjegjësisht me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate C.nr. 531/10 datë 28.10.2011, në arsyetim e saj është vërtetuar se paditësi nuk kishte përgjegjësi për lëshimin e kredisë në rastin e lartpërmendur, pasi që kjo ishte përgjegjësi ekskluzive e komitetit të kredive të të paditurës, prandaj nga kjo na del se vendimi i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit për rastin “Braha” është vendim i pa bazuar dhe i paargumentuar respektivisht, vendimi është bazuar në çështjen e njëjtë faktike dhe përmbajtësore, për të cilën njëherë gjykata ka vendosur për mos përgjegjësin e paditësit në rastin konkret. Po ashtu, Gjykata vlerëson se pas kthimit në punë të paditësit me vendim të gjykatës, ka qenë obligim i të paditurit që ta kthejë në punë paditësin me të gjitha të drejta që i ka pasur para ndërprerjes së punës, e të paraparë me Ligjin e Punës dhe Kontratën e parë të Punës me afat të pacaktuar, andaj zëvendësimi i kontratës me afat të caktuar nga ana e të paditurës-punëdhënësit është i pa bazuar dhe i pa ligjshme, pasi që është në kundërshtim me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Punës, për faktin se paditësi më herët kishte kontratë të punës në kohë të pacaktuar dhe si rrjedhojë e kësaj i padituri nuk ka pasur asnjë arsye ligjore që të bëjë zëvendësimin e kontratës me afat të caktuar, duke bërë shkelje të nenit 5 të Ligjit të Punës ku parashihet se është i ndaluar diskriminimi në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnim, promovimin e punësimin, kushtet e punësimin, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës.

Gjykata rikujton faktin që Ligji për Punë i jep autorizim punëdhënësit që në kushtet e caktuara t’ia ndërpresë marrëdhënien e punës të punësuarit, kjo nuk mund të nënkuptohet si e drejtë e punëdhënësit që të veprojë në mënyrë arbitrare ndaj punëmarrësve. Për më tepër, me vendimin e Prokurorisë Themelore në Prizren, është hudhur kallëzimi penal i të paditurit kundër paditësit, sepse nuk është gjetur se paditësi ka kryer veprën penale për të cilën është dyshuar, e gjithashtu edhe me vendimin e Inspektoratit të Punës, i padituri-punëdhënësi ishte gjobitur lidhur me shkeljet e Ligjit të Punës për veprimet që i ka ndërmarrë ndaj paditësit. Andaj, nga këto vlerësime, gjykata konsideron se vendimet e të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë të kundërligjshme, dhe si të tilla duhet t’i anulojë dhe njëherazi ta detyrojë të paditurën që paditësin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Meqenëse gjykata vlerëson se vendimi i të paditurit për largimin nga puna është marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 70 të Ligjit të Punës, përkatësisht se vendimin e të paditurës ishte cilësuar si shkeljet e supozuar në punë të paditësit për rastin “Braha”, ndërsa në anën tjetër për këtë

rast Gjykata me vendim të plotfuqishëm kishte vendosur njëherë për këtë rast, andaj në kuptim të nenit 80 të Ligjit të Punës, paditësit ia njohu edhe të drejtën e kompensimit në të ardhura të porealizuara të cilat i takojnë sipas kontratës së punës dhe Ligjit në Punë. Lartësinë e kompensimit gjykata e mbështeti në ekspertizën financiare të ekspertit të autorizuar të gjykatës, të cilës ia fali besimin në tërësi.

Gjykata ka vlerësuar edhe të provat tjera të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së dhe TA-së, dhe atë për një parashtesë 135 euro, për 5 përfaqësime gjithsejtë 675 euro, për ekspertizën financiare 150 euro, në shumën e përgjithshme të parave 955 euro, ndërsa shpenzimet e kërkuara për përpilimin e padisë gjykata nuk i aprovoi, pasi që të njëjtën nuk e ka përpiluar avokati Y. K., andaj edhe të njëjtit nuk i takon kjo pjesë e shpenzimeve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.34/13 më 16.12.2014

B. Profesional
Arlind Sharani

Gjyqtarja
Edije Sezairi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.